



MEMORANDUM MIRËKUPTIMI PËR PROJEKTIN

“Revitalizimi i rrugës Marin Barleti dhe kinemasë Lumbardhi në Prizren”

ndërmjet

Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë;

Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit;

Komunës së Prizrenit; dhe

Fondacionit Lumbardhi

Qëllimi i Memorandumit të Mirëkuptimit

Të krijohet një platformë për bashkëpunim të ngushtë dhe efikas ndërmjet Zyrës së Bashkimit Evropian, Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Komunës së Prizrenit dhe Fondacionit Lumbardhi për zbatimin e projektit “Revitalizimi i rrugës Marin Barleti dhe kinemasë Lumbardhi në Prizren”.

Qëllimi i Projektit

Të rinovohen shtëpitë dhe infrastruktura në rrugën Marin Barleti si dhe të rinovohet kinemaja Lumbardhi, të sigurohet mbrojtja dhe zhvillimi i qendrës historike të Prizrenit dhe në këtë mënyrë të përmirësohen kushtet për avancimin e zhvillimit të turizmit në zona të caktuara të trashëgimisë kulturore.

Obligimet e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë

- Zyra e Bashkimit Evropian është Autoriteti Kontraktues dhe do të financojë projektin “Revitalizimi i rrugës Marin Barleti dhe kinemasë Lumbardhi në Prizren”.
- Zyra e Bashkimit Evropian do të marrë përsipër të gjitha procedurat e prokurimit dhe dhënies së kontratës së punëve për kinemanë Lumbardhi dhe për rrugën Marin Barleti aktivitetet në vijim: mbulesën e re rrugore, përmirësimi i fasadave, pajisjet urbane duke përfshirë pajisjet e ndriçimit (pa kablo dhe pa nënstacione).
- Zyra e Bashkimit Evropian do të nominoj Kontraktuesin e suksesshëm për Kontratën e Punëve.

4. Zyra e Bashkimit Evropian do të caktojë një Asistencë Teknike me qëllim të kryerjes në emër të tyre tërë mbikëqyrjen dhe zbatimin e duhur të Kontratës së Punëve, duke përfshirë restaurimin e shtëpive për një periudhë kohore prej 18 muajsh pas nënshkrimit të kontratës së punimeve.
5. Zyra e Bashkimit Evropian do të caktojë një përfaqësues për Komitetin Drejtues i cili do të monitorojë, udhëheqë dhe koordinojë zbatimin e këtij projekti.

Obligimet e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit

1. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit do të bashkë-financojë projektin "Revitalizimi i rrugës Marin Barleti dhe kinemasë Lumbardhi në Prizren".
2. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit do të veprojë si pikë kontakti ndërmjet Zyrës së Bashkimit Evropian, Asistencës Teknike, Komunës së Prizrenit dhe Fondacionit Lumbardhi.
3. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit do të (Komisioni i Veçantë i themeluar për këtë projekt) miratojë me shkrim dizajnet e projektit para lansimit të tenderit të punëve.
4. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit do të themelojë një Komitet Drejtues me përfaqësuesit e të gjithë palëve pjesëmarrëse (hisedarëve) që do të monitorojnë, udhëheqin dhe koordinojnë zbatimin e këtij projekti.
5. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit do të ndërmarrë të gjitha procedurat e prokurimit dhe dhënies së kontratës për Revitalizimin e shtëpive në rrugën Marin Barleti.
6. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit do të monitorojë dhe lehtësojë zbatimin e projektit gjatë të gjitha fazave: së pari deri në Pranimin e Përkohshëm të projektit (d.m.th. dorëzimin tek komuna/Fondacioni Lumbardhi), dhe pastaj deri në Pranimin e Përhershëm të projektit.
7. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit do të mbështesë Zyrën e Bashkimit Evropian, Asistencën Teknike, Komunën e Prizrenit, Fondacionin Lumbardhi dhe Kontraktuesin e Punëve në zgjidhjen e problemeve që mund të paraqiten gjatë realizimit të projektit.
8. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit do të monitorojë funksionimin dhe mirëmbajtjen e duhur të objekteve nga komuna/Fondacioni Lumbardhi pas dorëzimit zyrtar tek këto të fundit.
9. Në qoftë se Komuna e Prizren apo Fondacioni Lumbardhi nuk bashkëpunojnë plotësisht gjatë të gjitha fazave të projektit apo neglizhojnë mirëmbajtjen e duhur të ndërtesave pas pranim/dorëzimit zyrtar, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit nuk do të marrë ato në konsideratë në të ardhmen për projekte të reja të financuara nga Bashkimi Evropian.

Obligimet e Komunës së Prizrenit

1. Komuna e Prizrenit pranon se ka miratuar me shkrim dizajnet e projekteve para lansimit të tenderit të punimeve.
2. Komuna e Prizrenit do të lëshojë lejet e ndërtimit për të dyja projektet para dhënies së kontratës.
3. Komuna e Prizrenit do të ndajë mjetet financiare, do të kryejë të gjitha procedurat e prokurimit dhe do të kontraktojë punimet e infrastrukturës nëntokësore (ujë, kanalizim,

telekom etj) dhe energjisë elektrike (nënstacion i ri nëse është i nevojshëm dhe kablllo të reja) për rrugën Marin Barleti dhe përmirësimin/zgjerimin e trotuarit në afërsi të kinemasë Lumbardhi.

4. Komuna e Prizrenit do të caktojë një përfaqësues për Komitetin Drejtues i cili do të monitorojë, udhëheqë dhe koordinojë zbatimin e këtij projekti.
5. Komuna e Prizrenit do të caktojë një person teknik me qëllim të monitorimit në emër të tyre të të gjitha fazave të zbatimit të projektit dhe do të veprojë si përfaqësuesi i tyre gjatë Pranimit të Përkohshëm dhe të Përhershëm të projektit.
6. Komuna e Prizrenit do të lidhë përsëri objektet e përfunduara në tërë infrastrukturën publike përkatëse (ujë, kanalizim, energji elektrike) me shpenzimet e veta.
7. Komuna e Prizrenit (dhe/ose Ministria në rastin e kinemasë Lumbardhi) do të zgjidhë çdo çështje ligjore dhe pronësore për tokën para fillimit të zbatimit të projektit. Megjithatë, nëse paraqitet ndonjë problem i papritur gjatë zbatimit të projektit, problemet e tilla duhet të trajtohen dhe zgjidhen nga komuna (dhe/ose Ministria në rastin e kinemasë Lumbardhi) në mënyrën më të shpejtë dhe të përshtatshme të mundshme.
8. Komuna e Prizrenit do të zgjidhë ndonjë problem apo çështje tjetër në kompetencë të saj që mund të paraqiten para apo gjatë zbatimit të projektit.
9. Komuna e Prizrenit do të ofrojë qasje të plotë për Kontraktuesin e Punëve në tërë dokumentacionin që ka të bëjë me infrastrukturën publike ekzistuese në dhe rreth parcelës së përmendur dhe të ofrojë mbështetjen e plotë kur ka të bëjë me infrastrukturën publike ekzistuese të përmendur (p.sh. ndalja e energjisë elektrike, uji apo kanalizimi për të kryer punimet në mënyrë të sigurt dhe në mënyrën e duhur).
10. Komuna e Prizrenit do të lëshojë Leje për Përdorim pas Pranimit të Përkohshëm të projektit.
11. Nëse Komuna e Prizrenit nuk bashkëpunon plotësisht gjatë të gjitha fazave të projektit apo neglizhon mirëmbajtjen e duhur pas pranim/dorëzimit zyrtar të objekteve, Zyra e Bashkimit Evropian mund të rishqyrtojë investimet e tij aktuale dhe të ardhme në komunë.

Obligimet e Fondacionit Lumbardhi

1. Fondacioni Lumbardhi pranon se ka miratuar me shkrim dizajnet e projekteve para lansimit të tenderit të punimeve.
2. Fondacioni Lumbardhi do të zgjidhë çdo problem ose çështje që mund të dalë para ose gjatë zbatimit të projektit.
3. Fondacioni Lumbardhi duhet të caktojë një person me qëllim të monitorimit në emër të tyre të të gjitha fazave të zbatimit të projektit dhe të veprojë si përfaqësuesi i tyre gjatë Pranimit të Përkohshëm dhe Përfundimtar të projektit.
4. Fondacioni Lumbardhi do të caktojë një përfaqësues për Komitetin Drejtues që do të monitorojë, udhëzojë dhe koordinojë zbatimin e këtij projekti.
5. Fondacioni Lumbardhi do të ofrojë qasje të plotë për Kontraktuesin e Punëve në tërë dokumentacionin që ka të bëjë me infrastrukturën publike ekzistuese në dhe rreth parcelës së përmendur dhe të ofrojë mbështetjen e plotë kur ka të bëjë me infrastrukturën publike

ekzistuese të përmendur (p.sh. ndalja e energjisë elektrike, ujit apo kanalizimit për të kryer punimet në mënyrë të sigurt dhe në mënyrën e duhur).

6. Fondacioni Lumbardhi do të lidhë përsëri objektet e përfunduara në tërë infrastrukturën publike përkatëse (ujë, kanalizim, energji elektrike) me shpenzimet e veta.
7. Nëse Fondacioni Lumbardhi nuk bashkëpunon plotësisht gjatë të gjitha fazave të projektit apo neglizhon mirëmbajtjen e duhur pas pranim/dorëzimit zyrtar të objektit, Zyra e Bashkimit Evropian mund të rishqyrtojë investimet e tij aktuale dhe të ardhmen në kinemanë Lumbardhi.

Marrëveshja e plotë


Ky Memorandum Mirëkuptimi është përpiluar në shqip dhe anglisht dhe është nënshkruar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Komuna e Prizrenit dhe Fondacioni Lumbardhi në katër ekzemplarë origjinalë (nga një për secilën palë) dhe është bërë në pajtim të plotë me të gjitha palët. Ky Memorandum Mirëkuptimi do të ndryshohet vetëm pas një pëlqimi me shkrim nga të gjitha palët nënshkruese. Ky Memorandum do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë. Në rast të mospërputhjeve ndërmjet versioneve të ndryshme, atëherë versioni në gjuhën angleze do të mbizotërojë.

Nënshkruesit

(data dhe nënshkrimi)


Zyra e BE-së në Kosovë – Shefi i seksionit për bashkëpunim:

Johannes STENBAEK MADSEN

29/12/2022



Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit – Ministri

Hajrrulla ÇEKU




Komuna e Prizrenit – Kryetari

Shaqir TOTAJ



Fondacioni Lumbardhi – Drejtori Ekzekutiv

Ares SHPORTA


19/12/22